



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORIA PRANË GJYKATES SË SHKALLES SË PARË LEZHË

V E N D I M
PËR PUSHIMIN E HETIMEVE TË PROCEDIMIT PENAL NR. 615/2013

Në Lezhë, sot me dt 21.02.2017.

Unë **Erjon SHEHAJ**, Prokuror ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Lezhë, pasi studiova materialet e administruara ne aktet e procedimit penal Nr. 615 të vitit 2013, qe bejne fjale per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

K O N S T A T O V A:

Se, mbi bazen e materialeve te para hetimore te derguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë me date 09.10.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Lezhë, ka regjistruar procedimin penal Nr. 615, per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" te parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal,

Si indicje për fillimin e procedimit penal ka shërbyer informacioni i dërguar nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Lezhë.

Sipas informacionit të disponuar rezulton se: *shtetasi Astrit Nimani eshte i shpallur ne kerkim nderkombetar, pasi Gjykata e Milanos, Itali, me Vendimin Nr. 3558/2011 SIEP, date 26.09.2011, e ka dënuar këtë shtetas me 7 (shtate) vjet, heqje lirie, për kryerjen e veprës penale të "Trafikut të lëndëve narkotike".*

Krahas informacionit të dërguar nga Drejtoria për Krimin Ekonomik e Financiar, Tiranë, i është kërkuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut, Lezhë :

Identifikimi i pasurive të luajtshme apo të paluajtshme si dhe bizneset, që ky shtetas dhe familjarët e tij i kanë faktikisht, por të regjistruar në emra të tjerë.

Nga veprimet paraprake të kryera nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Lezhë, rezulton se:

Shtetasi Astrid LiMANI, i biri i Uk dhe i Rushe, i dtl. 18.04.1971, lindur ne Lezhe dhe banues ne lagjen "Varosh",Lezhe, i martuar, me kombesi e shtetesi shqiptare, ka bere ndryshimin e gjeneraliteteve nga

Astrit Nimani ne Astrid Limani dhe se janë identifikuar pasuritë e mëposhtëme:

- 1 (një) objekt ne qytetin e Shengjinit te quajtur "Ermiri Palac" me sherbime bar restorant e hoteleri 3.5 katesh.
- 150 shezlongje te kompletuara e te vendosura ne reren e plazhit para hotelit te siperpermendur.
- 1 (një) lokal ne formen e pistes në detë perballë hotelit "Ermiri Palac".
- 1 (një) pallat 10 (dhjetë) katesh ngjitur me objektin e mesiperm te cilin sipas burimeve te sigurta nuk e ka te regjistruar dhe me lejen perkatese.
- 1 (një) pallat 15 (pesëmbëdhjetekatesh) te perfunduar dhe te shitur si apartamente banimi
- 1 (një) pallat 12 (dymbëdhjetekatesh) te perfunduar e shitur si apartamente banimi ne zonen turistike te Shengjinit.

Objektet e lartepermendura si dhe kompleksi turistik "Ermiri Palace" gjenden te ndërtuara ne nje vije te drejte me njera tjetren ne qytetin e Shengjinit te rrethit Lezhë.

Gjithashtu ky shtetas ka në pronesi:

- 1 (nje) autoveture tip fuoristrade luksoze te tipit "Audi Q7" me targe TR 3636 T, ku nga verifikimi i saje rezulton se eshte ne pronesi te subjektit "Raifeisen bank".
- 1 (një) Jaht turistik luksoz i cili është i ankoruar ne det ne afersi te kompleksit turistik te quajtur "Ermiri Palac", ne qytetin e Shengjinit. Ky jaht quhet "Ermiri Palac".
- 2 (dy) skafe me mbishkrimin "Ermiri Palac" te cilat perdoren per shetitje turistike ne detë.
- 1 (një) vile banimi ne lagjen "Varosh" te bashkise Lezhë rreth 150 meter larg Spitalit Rajonal Lezhe.

Për të verifikuar nëse ekziston vepra mëmë dhe nëse ka rekorde kriminale në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur me dy gjeneralitetet, që do të mundësonte fillimin e procedimit penal për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, i është kërkuar informacion Zyrës Ndërlidhëse së Policisë Italiane me Shqipërinë, Interforce, Tiranë.

Në përgjigjen e ardhur rezulton:

Shtetasi Astrit NIMANI ka ndryshuar gjeneralitetet ne Astrid LIMANI, i biri i Uk dhe Rushe lindur ne Lezhe me 18.04.1971, posedues i pasaportes shqiptare me nr. BE0017656, e leshuar me date 23.08.2012. Duke konsideruar faktin qe Interpol Tirana ka komunikuar qe shtetasi i cituar ne lende ndodhet ne Shqiperi prane baneses se tij, dhe eshte pronar i Hotelit ERMIRI PALACE, Lezhe, Shengjin por qe nuk mund ta arrestoje me qellim ekstradimin ne drejtim te Italise pa nje perditesim te shpalljes ne kerkim me gjeneralitetet e reja, Zyra jone Qendrore ne Rome

ka informuar Autoritetin Gjyqesor kompetent Italian, me qëllim që të shtrijë urdher arrestin në fushe nderkombetare me qëllim ekstradimit e ketij subjekti në drejtim të Italisë me gjeneralitetet e reja, duke qenë se në ngarkim të tij është leshuar:

- a. Masa e sigurisë arrest në burg nr. 784/2007 R.G.G.I.P - N 6167/07 R.G.N.R me datë 13.02.2007 nga Gjykatesi për Hetimet Paraprake pranë Gjykates në Milano për trafik ledesh narkotike të kryer në bashkëpunim (masa i është ngarkuar për ekzekutim Qendres së P.T.Gdf-GOA Torino);
- b. Masa e sigurisë arrest në burg nr. 1057/2007 RGNR-nr. 1465/05RGGIP e Gjykates në Lucca-Zyra e Gjykatesit për Hetimet paraprake me datë 31.05.2005 për shkelje të ligjit mbi lëndet narkotike- Operacioni "Red Horse" - (masa i është ngarkuar për ekzekutim Compagnia Carabinieri N.O.R.M në Lucca".

Në përgjigje të saj, Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana, informon se: "shtetasi Astrit Limani ka qënë i shpallur në kërkim nderkombëtar nga Interpol-Roma, Itali pasi Gjykata e Milanos me Vendim Nr.784/2007 RGGIP.N.6167/07 RGNR, datë 22.02.2007 ka lëshuar Urdhër Arrestin Ndërkombëtar për këtë shtetas për kryerjen e veprës penale të bashkëpunimit kriminal me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike, parashikuar nga nenet 81 dhe 110 të K.Penal, Italian. Aktualisht kërkimi për këtë shtetas është anuluar pasi është arrestuar më datë 15.11.2013, në Serbi dhe më datë 20.12.2013 është ekstraduar drejt Italisë".

Nga ana jone po hetohet se cila është forma dhe mekanizmi, cila është veprimtaria penale apo vepra penale, nga e cila dyshohet se kanë buruar të ardhurat e paligjshme dhe si janë integruar duke i justifikuar si të ardhura të ligjshme;

Veprimtaria kriminale në shtetin italian ku dyshohet se kanë buruar të ardhurat të cilat janë integruar në: prona të paluajtshme, të luajtshme, llogari bankare, biznese.

Cila është forma dhe mekanizmi i përdorur për integrimin e tyre.

Forma dhe mekanizmi, përdorur për integrimin e tyre janë:

Çelja e llogarive bankare në shumën të mëdha në emër të tij dhe familjarëve të tij;

Krijimi i aktiviteteve private në emër të tij dhe familjarëve të tij;

Blerja e automjeteve luksoze në emër të tij dhe familjarëve të tij;

Investimi në fushën e ndërtimit në emër të tij dhe familjarëve të tij, të cilat nuk justifikohen me të ardhurat legale që ky shtetas mund të siguroj nga bizneset e ligjshme.

Kush është burimi i të ardhurave në mënyrë kronologjike kohore dhe si janë justifikuar në kuptimin ekonomik, duke investuar në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në emër të tij apo familjarëve.

Burimi i të ardhurave dyshohet veprimtaria e shtetasit në shtetin italian "për kryerjen e veprës penale" të bashkëpunimit kriminal me qëllim

4

trafikimin e lëndëve narkotike, bazuar në përgjigjet e përmëndura më lart, ardhur nga Zyra Ndërlidhëse e Policisë Italiane me Shqipërinë, Interforce, Tiranë dhe Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol Tirana.

Per sa me siper, per sqarimin e plote te rrethanave te faktit, meqenese ekziston dyshimi se shtetasi Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI, i biri i Uk dhe i Rushe, i datëlindjes 18.04.1971, lindur ne Lezhe dhe banues ne lagjen "Varosh",Lezhe, me kombesi e shtetesi shqiptare, ka kryer vepren penale të « Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale » parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, (nese ndaj tij nuk eshte dhene ndonje vendim gjykate per rastin objekt hetimit), në mbeshtetje të Konventes Evropiane "Per ndihmën e ndersjellite ne fushen penale" neni 14, ligjit Nr. dhe nenit 509/1 te K.Pr.Penale, me anë të leterporosisë i është kërkuar Autoriteteve Kompetente Italiane te Drejtesise qe te procedojne me:

1. *Te na vihet ne dispozicion ne rruge zyrtare e ligjore nje kopje e Vendimit te Gjykates se Milanos, konkretisht Vendimi Nr.784/2007 RGGIP.N.6167/07 RGNR, datë 22.02.2007, që ka lëshuar Urdhër Arrestin Ndërkombëtar për këtë shtetas për kryerjen e veprës penale të bashkëpunimit kriminal me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike, parashikuar nga nenet 81 dhe 110 të K.Penal, Italian, pasi aktualisht kërkimi për këtë shtetas është anuluar pasi është arrestuar më datë 15.11.2013, në Serbi dhe më datë 20.12.2013 është ekstraduar drejt Italisë.*
2. *Masa e sigurise arrest ne burg nr. 784/2007 R.G.G.I.P - N 6167/07 R.G.N.R me date 13.02.2007 nga Gjykatesi per Hetimet Paraprake prane Gjykates ne Milano per trafik lendesh narkotike te kryer ne bashkepunim (masa i eshte ngarkuar per ekzekutim Qendres se P.T.Gdf-GOA Torino);*
3. *Masa e sigurise arrest ne burg nr. 1057/2007 RGNR-nr. 1465/05RGGIP e Gjykates ne Lucca-Zyra e Gjykatesit per Hetimet paraprake me date 31.05.2005 per shkelje te ligjit mbi lendet narkotike- Operacioni "Red Horse" - (masa i eshte ngarkuar per ekzekutim Compagnia Carabinieri N.O.R.M ne Lucca".*
4. *Te na vihet ne dispozicion edhe praktika e dokumentacionit te shpalljes se ketij shtetasi ne kerkim nga autoritet Italiane.*
5. *Te na vihet ne dispozicion praktika e arrestimit te shtetasit te lartpermendur ne shtetin e Serbise dhe ajo e ekstradimit te tij ne shtetin Italian.*

Eshte kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë vendosja e sekuestros preventive për pronat e shtetasit Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarëve të tij dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin e saj nr 186 datë 12.06.2015, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe vendosjen e sekuestros preventive për pronat e shtetasit Astrit



5

NIMANI *alias* Astrid LIMANI. Për këtë vendim Gjykate është nxjerr urdhëri i ekzekutimit dhe është ekzekutuara nga ZVRPP Lezhë.

Nga ana e autoriteteve gjyqesor Italiane janë derguar aktet në ngarkim të shtetasit Astrid Limani dhe nga ana e Prokurorisë Prane Gjykates e Shkalles e Pare Lezhe është vendosur rifillimi i hetimeve për këtë procedim penal dhe emri i shtetasit Astrid Limani është rregjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, si person nën hetim për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale" të parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal.

Nga aktet e derguara nga shteti Italian rezulton se për shtetasin Astrid Limani është dhënë një vendim gjykate sipas të cilit ky shtetas është denuar me 10 vite burg për veprën penale të parashikuar nga neni 81 K.P. Italian.

Pas daljes nga burgu është paraqitur në Prokurorinë Prane Gjykates së Shkalles së Pare Lezhe shtetasi Astrid Limani i cili ka deklaruar se: Në vitin 1991, babai i tij Uk Nimani, ka blerë nga shteti, nga Prefektura e Lezhës sipërfaqen e tokës truall prej 420 m², e ndodhur në Shengjin Lezhe, tek ish kampi i pionierit, zona kadastrale 3126. Mbi këtë truall nga babai i tij është ndertuar një hotel 5 kt me leje të rregullt ndertimi. Ky objekt është ndertuar në vitin 2001. Për ndertimin e këtij objekt babai i tij ka marrë një kredi nga dega e bankës së kursimit Lezhe në shumën prej 2 440 000 leke të reja. Në lidhje me kredinë e marrë shpjegon se babai i tij ka marrë në vitin 1996 nga banka e kursimeve Lezhe shumën prej 5 280 530 leke kredi për rikonstruksionin e një objekti 2 kt të ndodhur në lagjen Gurra Lezhe prona e tij. Në vitin 2001, meqenese donte të ndertonte këtë objekt, ka kërkuar pranë bankës ristiktrim kredie duke i dhënë shumën prej 2440 000 leke të reja. Po kështu babai i tij nëpërmjet kontratës së huase i ka marrë shtetasit Ilir Hoxhaj shumën prej 742.400 euro. Perseri nga babai i tij Uk Nimani është blerë një sipërfaqe toke prej 1321 m² nga shtetasit Besim Leknikaj, Dorian Leknikaj, Brahim Leknikaj, Xheladin Leknikaj dhe Isen Leknikaj. Kjo toke ndodhet në Shengjin Lezhe, në zonën Kadastrale 3126. Në këtë truall në vitin 2006 është ndertuar një pallat 8 kt + papafingo mbi bazen e lejes së rregullt të ndertimit. Ky pallat është ndertuar nga ana e tij pas kalimit të pronave të babait të tij në baze të deshmisë së trashëgimisë, pas vdekjes së babait. Ky objekt është ndertuar nga ana e tij me një financim të dhënë nga BKT dega Lezhe, kredi të dhëna nga BKT. Nga ana e BKT i janë dhënë tre kredi, njëra në shumën 80 000 000 leke të reja, kredia e dytë 17 000 000 leke të reja, kredia e tretë 70 000 000 leke të reja. Në vitin 2001 nga babai i tij Uk Nimani është blerë një sipërfaqe trualli prej 520 m² e ndodhur në Shengjin Lezhe Lezhe. Në këtë sipërfaqe toke truall babai i tij ka ndertuar një objekt 3 katesh dhe një objekt 5 kt që e përmenda me sipër hotel. Në vitin 2010 shoqëria Kalaja Impeks sh.p.k ka ndertuar me leje të rregullt ndertimi pas prishjes së objektit 3 kt (ka marrë leje për prishje), një objekt 12 katesh me leje ndertimi dt 28.12.2010, me nr 43. Ky objekt është financuar nga banka NBB dega

Lezhe, Raiffaesen dega Lezhe. Nga NBG i jane dhene 300 000 euro dhe nga Raiffaesen i jane dhene 950 000 euro. Nje pjese e madhe e apartamenteve ne objektet 8 kt dhe 12 kat u jane shitur nga ana e tij personave te ndryshem. Me dt 28.12.2004, babai i tij Uk Nimani ka vdekur. Pas vdekjes se babait te tij me vendimin gjyqesor nr 70, dt 28.02.2005, nga ana e Gjykates Lezhe eshte leshuar deshmia e trashegimise ligjore te trashegimlenesit Uk Nimani ku te gjitha pronat e babait te tij kane kaluar trashegimtarve ligjore qe ka qene nena Adlija, Astritit, Arteida motres, Erjoni vella. Ka ndertuar mbi pasurite qe i ka lene babai i tij. Ka ndertuar me kredi te marra nga bankat ne Shqiperi si dhe me fitimet qe ka marre nga shitjet e apartamenteve. Kredine qe ka mare nga bankat e ka paguar me shitjet e apartamente, me fitimet qe kane ardhur nga hoteli 5 kt qe i ka lene babai i tij. Ne vitin 1994, babai i tij ka hapur nje biznes Kalaja Impeks sh.p.k, biznes i madh i rregjistruar prane organe te shtetit. Ky biznes ka pasur si aktivitet shitje dhe blerje mallrash te ndryshme. Qe ne vitin 1993 babai i tij ka pasur nje bar restorant ne lagjen gurra dyqan. Per ndertimin e ketij dyqani babai i tij fillimisht ka blere truallin qe ja ka blere shtetit, keshillit te rrethit Lezhe, ne baze te vendimit nr 735 prot dhe me pas me leje ndertimi ka ndertuar objektin dyqan tregtie prej 650 m2. Ne vitin 1991, ka pasur nje lokal tek spitali i Lezhes. Po keshtu babai i tij ka pasur nje dyqan akulloresh ne Shengjin Lezhe. Babai i tij ka punuar ne menyre te rregullt me biznesin e vet. Ne Shqiperi nuk eshte denuar asnjehere. Ne vitin 2011, eshte denuar ne mungese ne Itali per ngjarjet e vitit 2002 me 10 vjet burgim. Eshte arrestuar me dt 15.11.2013. Kur eshte arrestuar eshte hapur perseri procesi dhe perfundimisht eshte denuar 7 vjet burg. Ka qendruar ne burg deri me dt 04.12.2016. Eshte denuar nga gjykata e Milanos per krime te lehta, gje qe e verteton fakti se atij i jane falur nga gjykata 3 vite burgim dhe 345 dite i ka falur burgu per arsye se ai ka perfituar lehtesira se nuk kam qene person i rrezikshem. Pasurite e tija i ka bere me pronat qe i ka lene babai i tij, me kredite marra ne bankat e Shqiperise, nga fitimet qe kane ardhur nga puna e familjes se tij ne hotelet e lena nga babai i tij, nga fitimet qe kane ardhur nga shitja e apartamenteve.

Ne fashikullin e procedimit penal eshte administruar dokumentacioni i dorezuar nga shtetasi Astrid Limani, dokumentacioni mbi denimin e tij ne Itali si dhe dokumentacioni mbi pasurite e tij.

Nga dokumentacioni mbi denimin e tij ne Itali rezulton se shtetasi Astrid Limani eshte denuar perfundimisht nga Gjykata e Milanos Itali me 7 vite burgim, denimi i ka filluar me date 15.11.2013 dhe i ka perfunduar me dt 04.12.2016. Nga ana e gjykates i jane falur 3 vite burgim dhe 345 dite i jane falur nga burgu. Eshte liruar nga burgu per mbarim te denimit. Nga dokumentacioni i dorezuar per pronat e tij rezulton se ky shtetas eshte trashegimtar ligjor i te ndjerit Uk Nimani dhe se pronat e tij i ka vene ne baze te pasurive qe i ka lene babai i tij Uk Nimani dhe kredive qe ka mare ne bankat e nivelit te dyte.

7

Nga teresia e hetimeve dhe provave te grumbulluara ne lidhje me kete proçedim penal arrijme ne perfundimin se nga ana e personit nen hetim shtetasit Astrid Limani nuk eshte kryer vepra penale e «Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale» te parashikuar nga neni 287 te K.Penal. Shtetasi Astrid Limani eshte denuar nga Gjykata e Milanos ne Itali per ngjarje te ndodhura ne vitin 2002. Shtetasi Astrid Limani shumicen e pasurive i ka trasheguar nga babai i tij Uke Nimani pasuri te cilat jane krijuar nga babai i tij para vitit 2002. Po keshtu pasurite e tjera te krijuara pas vdekjes se babait te tij Uke Nimani i ka bere me financime (ka marre kredi) nga bankat e nivelit te dyte ne Republikën e Shqiperise, me te ardhurat qe jane krijuar nga pronat e babait te tij si dhe me shitjen e apartamenteve.

Nga hetimet e kryera nuk rezulton qe te keto pasuri te jene krijuar nga te ardhurat e veprimtarise kriminale te shtetasit Astrid Nimani, veprimtari per te cilen ky shtetas eshte denuar dhe ka vuajtur denimin ne shtetin Italian.

Ne keto kushte, proçedimi penal ne ngarkim te shtetasit Astrid Limani per vepren penale «Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale» te parashikuar nga neni 287 të Kodit Penal, duhet pushuar

Për sa më sipër, ne bazë të nenit 328, pika 1, germa b, te K.Pr.Penale,

V E N D O S A:

1. Pushimin e proçedimit penal nr Nr. 615 të vitit 2013, qe ben fjale per vepren penale te «Pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale» të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, ne ngarkim te shtetasit Astrid Limani.
2. Ne baze te nenit 261, pika 1, germa «a» te K.Pr.Penale, shuarjen e mases se sigurimit pasuror «Vendosje sekuestro preventive», parashikuar nga neni 274 te K.Penal, vendosur me vendimin nr 186, dt 12.06.2015, te Gjykates se Shkalles se Pare Lezhe, per pasurite e shtetasit Astrit NIMANI *alias* Astrid LIMANI dhe familjarëve të tij.
3. Me këtë vendim të njoh personat e interesuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe tek prokurori më i lartë.

PROKURORI
Erjon SHEHAJ

